

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

datë. 15.07.2013
Nr.0204-858

PËR: Agron Kuçi, Kryetar i Komunës së Junikut,
Sinan Gacaferi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut,

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT Nr.001/06, të pranuar më datën 28.06.2013.

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit, Nr.001/06, të miratuar me datë 30.04.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.


Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendim Nr.001/06, për shpalljen e parcelës kadastrale nr.3262 me interes publik në komunën e Junikut.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL-së,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana. 15.07.2013
Br. 0204-858

Za: Agron Kuçi, Gradonačelnik Opštine Junik
Sinan Gacaferi, Predsedavajući Skupštine Opštine Junik

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE JUNIK Nr.001-06 primljene dana 28.06.2013.

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke, Nr.001-06, usvojene dana 30.04.2013, **POTVRJUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu.

Pravni Akt niže navaden ima puni pravni efekat.

- Odluka 0Nr.001-06, za objavljivanje katastarske parcele br. 3262 od javnog interesa u opštini Junik.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanikpremijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivi MALS-a.



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT


MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Kuvendi i Komunës

Nr. 001/06

Datë: 30.04.2013



Në bazë të nenit 12.2 paragrafi d) i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); nenit 10 paragrafi b); dhe nenit 22 paragrafi 4) i Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 30.04. 2013, merr:

VENDIM PËR

SHPALLJEN E PARCELËS KADASTRALE 3262 INTERES PUBLIK I KOMUNËS SË JUNIKUT

I. Me këtë Vendim shpallet interesi publik i Komunës së Junikut për një pjesë të parcelës kadastrale numër 3262.

II. Objekti i shpronësimit të pronës së paluajtshme sipas këtij vendimi do të jetë sipërfaqja prej 1600 m² (16 ari) nga parcela kadastrale numër 3262.

III. Parcela kadastrale numër 3262 evidentohet në Të Dhënat Bazë për Njësi P-73105038-03262-0 është pronë private e bashkëpronarëve Xhafer (Adem) Gaxherri dhe Avni (Qazim) Gaxherri me nga 1/2 e pjesëve ideale. Parcela kadastrale ka sipërfaqe të përgjithshme prej 8946 m², me kulturë është livadh dhe gjendet në vendin e quajtur Ulëza - Ura e Trarëve.



IV. Në një pjesë të parcelës kadastrale numër 3262 komuna planifikon të ndërtojë impiantin për trajtimin e ujërave të zeza (dega lindje) me të gjithë infrastrukturën përcjellëse sipas projektit të përbashkët të Komunës së Junikut dhe Komisionit Evropian.

V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i komunës.

VI. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohet:

- MAPL,
- Pronaret ose zotëruesit e interesit,
- Arkiva e Komunës Junik.



Kryetari i Kuvendit
Sinan Gacaferi